



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 48, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/ 16 dhe 83/18) dhe pikës 12, paragrafi 3 të Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistmore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 26/17), guvernatorja e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi:

UDHËZIM

për ndryshimin e Udhëzimit për zbatimin e Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistmore

("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/20)

1. Në Udhëzimin për zbatimin e Vendimit për metodologjinë e identifikimit të bankave me rëndësi sistmore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/17), në pikën 6, paragrafi 2, nënparagrafët 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"- vlera maksimale e nënkategorisë së pestë është shuma e vlerësimit përmbledhës të bankës me rëndësinë më të lartë sistmore deri më 31 dhjetor 2019 (2.462 pikë bazë) dhe devijimit standard nga vlerësimet përmbledhëse të bankave të identifikuar me rëndësi sistmore (635 pikë bazë);

- intervalet për secilën nënkategori me rëndësi sistmore përcaktohen duke pjesëtuar me 4 dallimin ndërmjet vlerës maksimale të paragrafit 2 të këtij paragrafi (3.097 pikë bazë) dhe vlerës minimale të paragrafit 1 të këtij paragrafi (350 pikë bazë) dhe kjo vlerë (687 pikë bazë) i shtohet kufirit të poshtëm të çdo nënkategorie me rëndësi sistmore."

Paragrafi 3 ndryshohet si më poshtë:

"Këto përlllogaritje kanë të bëjnë me të dhënat e 31 dhjetorit 2019, me ç'rast kufijtë e nënkategorive me rëndësi sistmore janë fikse deri në llogaritjen me gjendjen më 31 dhjetor 2021."

2. Shtojca nr. 2 Shtresa mbrojtëse e kapitalit për çdo nënkategori me rëndësi sistmore, zëvendësohet me shtojcë të re nr. 2 që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

U nr. 16-12043/1
27 prill 2020
Shkup

Guvernatorja
Dr. Anita Angellovska-Bezhoska

Shtojcë nr. 2**Shtresa mbrojtëse e kapitalit për çdo nënkategori me rëndësi sistemore**

Nënkategori me rëndësi sistemore	Interval	Shtresë mbrojtëse e kapitalit për bankat me rëndësi sistemore
5	mbi 3.097	3,5%
4	mbi 2.410 deri 3.097	2,5%
3	mbi 1.724 deri 2.410	2,0%
2	mbi 1.037 deri 1.724	1,5%
1	350 deri 1.037	1,0%